



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC  
OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Drejtoria e Arsimit**

**04 Nr.219**

**Më:04.05.2023**

Duke u bazuar në UA nr.02/2016 për Aktivitetet Jashtëshkollore i dt.12/01/2016, Ofertën me numër protokollit 379/01 i dt.07.04.2023 i anuluar për shkak të mos përmbushjes së kërkesës nga kompanitë ( duke konkuruar më pak se tre) . Rishpallët nga SHMLE “ Kadri Kusari” në Gjakovë me dt:19.04.2023, me numër protokollit 400/01, lidhur me organizimin e ekskursionit për maturantë në SHMLE “Kadri Kusari” në Gjakovë, për bartjen e nxënësve në Republikën e Shqipërisë me qëndrim në Durrës. Nga Durrësi vizitohen: Vlora, Kruja, Tirana dhe qyteti i Durrësit. Ekskursioni zgjatë 3 buajtje (katër ditë), pansion i plotë) prej datës 23/05/2023 deri më 26/05/2023. Lista e konkurentëve për të fituar Ofertën për ekskursion të maturantëve të SHME ”Kadri Kusari” në Gjakovë, janë :

1. NPT “Armendi -Tours” me çmim 150.00 €
- 2.”Meti –Tours” SHPK me çmim 100.00 €;
- 3.“Bledi Bus” SH.P.K me tre (3) çmime 105, 115 , 115 ,00€
- 4.“Kushtrimi NMI” me çmim 120.00€

**Raport i Komisionit selektues:**

Hapja e ofertave u bë me dt.25/04/2023 në ora 14:02 sipas ofertës nr.400/01 i dt.19/04/2023 ku prezent kanë qenë përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit dhe SHMLE ”Kadri Kusari” Gjakovë :

1. z.Merita Bokshi – Drejtor i SHMLE
2. z.Anton Pnishi.- Përfaqësuesi i Këshillit Drejtues të SHMLE ”Kadri Kusari” në Gjakovë
3. z.Dukagjin Ademi – zyrtar i DKA-së
4. z.Bujar Nuqi – Zyrtar ligjor i DKA-së (procesmbajtës)

Të gjitha ofertat janë hapur dhe lexuar në praninë e kompanive konkurruese.

**Firma transportuese NTP “Armendi -Tours”-Gjakovë** ka konkuruar me çmim 150.00 , por nuk i ka kompletuar dokumentacionin sipas ofertës së shkollës .

**Firma transportuese “Meti -Tours” SHPK -Gjakovë** ka konkuruar me çmim prej 100.00€ për nxënës, ku në këtë çmim ka ofruar që kujdestarët e klasave lirohen nga të gjitha obligimet e këtij ekskursioni, kompania merr përsipër bartjen e nxënësve në mbrëmjen e maturës , të gjithë nxënësit janë të liruar nga të gjitha obligimet për shfrytëzimin e plazhit dhe shfrytëzimin e pishinës brenda hotelit.

Oferta bazohet në 3 (tre) buajtje, qëndrim katër ditor me pansion të plotë, ku ju është ofruar qëndrim në Hotel “Bonita” Shpk Golem-Durrës prej dt.23/05/2023 deri më 26/05/2023 dhe vizitat në qytetet Vlorë , Krujë , Tiranë dhe qyteti i Durrësit gjithashtu ka prezantuar edhe menynë për këto 4 ditët e qëndrimit të nxënësve.

Janë të përfshirë katër (4) shoferë të pajisur me certifikata mjekësore dhe janë prezantuar 4 autobusë , ku dhe i plotësojnë kushtet për bartjen e fëmijëve pasi që janë rreth 115 nxënës.

Firma posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licencë kjo e vlefshme nga dt.07/06/2019 gjerë më dt.06/06/2024. Ka prezantuar Çertifikatën e Regjistrimit, Kontrollin teknik 6 mujor të autobusëve sipas procedurave ligjore, ka ofruar 3 referenca me imazh pozitiv, Vërtetimin Tatimor dhe Komunal, Licencën e Punës Dr. Baton Lleshi së bashku me kontratën e punës të kontraktuar nga kompania SHPK ”Meti Tours” për kryerjen e shërbimeve mjekësore për nxënësit (maturantët).

Ka prezantuar Konfirmim rezervimi nga administratori Astrit Ismaili të Hotelit “Bonita” në Durrës me kompaninë ”Meti Tours” SHPK, Licencën e agjensionit të akreditimit të ushqimeve sipas ofertës me nr.prot.400/01 të dt.19.04.2023 pika (5) të SHMLE “Kadri Kusari” në Gjakovë.

**Firma transportuese “Bledi Bus” SH.P.K-Gjakovë** ka konkuruar me çmim prej 105€, në 1.Bonita Luxory, 2.Hotel Harmonia Grup me çmim 115€, 3. Hotel Kamelia Resort me çmim 115 €, për nxënës ku iu është ofruar qëndrim 4 ditor, tre (3) buajtje prej dt.23.05.2023 deri më 26.05.2023. ku në këtë çmim ka ofruar që kujdestarët e klasave lirohen nga të gjitha obligimet e këtij ekskursioni, kompania merr përsipër bartjen e nxënësve në mbrëmjen e maturës , të gjithë nxënësit janë të liruar nga të gjitha obligimet për shfrytëzimin e pishinave të jashtme në të gjitha hotelet. Në ofertë nuk janë paraqitë vizitat e qyteteve sipas ofertës së shkollës “Kadri Kusari” në Gjakovë .

Firma posedon Liçencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, liçencë kjo e vlefshme nga dt.03/02/2023 gjer më dt.10/01/2026. Ka prezantuar Certifikatën e Regjistrimit, Kontrollin teknik 6 mujor të autobusëve, sipas procedurave ligjor, posedon Liçencen e punës të Dr.Hamdi Kameri se bashku me kontratën e punës të kontraktuar nga kompania “Bledi Bus” SH.P.K, kontrata e nënshkruar dhe e vulosur nga Kompania në fjalë e nënshkruar dhe jo e vulosur nga ana e Dr..Hamdi Kameri , për përkuqjesjen e nxënësve (maturantëve) të SHMLE “Kadri Kusari” në Gjakovë. Për transportin e nxënësve ka përfshirë 5 shoferë dhe 5 autobusë ku sipas ofertës për ekskursion i plotëson kushtet, pasi që numri i nxënësve është rreth 115 nxënës.

Ka prezantuar Konfirmim rezervimi nga administratori Astrit Ismaili të Hotelit “Bonita” në Durrës me pronarin e “Bledi Bus” SH.P.K, (Kurse në ofertë e ka të shkruar Bonita Luxury, gjë që nuk përkon me kompleksin në fjalë). Licencën e agjensionit të akreditimit të ushqimeve sipas ofertës me nr.prot.400/01 dt.19.04.2023 pika (5) të SHMLE “Kadri Kusari” në Gjakovë.

Ka prezantuar Konfirmim rezervimi nga administratori Kamelia Resort-Shkëmbi i Kavajës, Durrës me pronarin “Bledi Bus” SH.P.K, Certifikatë e regjistrimit,Certifikatë shërbimi “ARLI” ,Certifikatë kategorizimi(strukturë akomoduse) nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit,Çfiskalizimi i pajisjeve fiskale nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë .

Ka prezantuar Konfirmim rezervimi nga administratori (i autorizuar –Sara Zekthi ) . Harmonia Hotels Group dhe “Bledi Bus” SH.P.K , Liçencen e agjensionit të akreditimit të ushqimeve sipas

ofertës me numër të protokollit 400/01 te dt: 19.04.2023 pika (5) të SHMLE “ Kadri Kusari” në Gjakovë

**Firma transportuese “Kushtrimi NMI” -Gjakovë** ka konkuruar me çmim prej 120 €, në Hotel Kamomil , për nxënës ku iu është ofruar qëndrim 4 ditor , tre (3) buajtje prej dt.23.05.2023 deri më 26.05.2023, ku në këtë çmim ka ofruar stafin shkollor dhe dy nxënës që të lirohen nga të gjitha obligimet e këtij ekskursioni, kompania nuk e ka specifikuar bartjen e nxënësve në mbrëmjen e maturës . Në ofertë nuk janë paraqitë vizitat e qyteteve të Shqipërisë, sipas ofertës së shkollës “Kadri Kusari” në Gjakovë .

Firma posedon Liçencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, liçencë kjo e vlefshme nga dt.15/04/2021 gjer më dt.14/04/2026. Ka prezantuar Certifikatën e Regjistrimit, Kontrollin teknik 6 mujor të autobusëve, sipas procedurave ligjor, posedon Referencë të lëshuar nga SHF “Këlmend Rizvanolli” në Gjakovë ,referencë nga Ngrohtorja e qytetit SH.A-Gjakovë, posedon Liçencen e punës të Dr.Xhevat Musaj se bashku me kontratën e punës të kontraktuar nga kompania “Kushtrimi” NMI ,kontrata e nënshkruar dhe e vulosur nga pronari Kreshnik Musa , po ashtu e nënshkruar dhe e vulosur edhe nga ana e Dr.Xhevat Musaj , për përkujdesjen e nxënësve (maturantëve) të SHMLE “Kadri Kusari” në Gjakovë. Për transportin e nxënësve ka përfshirë 4 shoferë dhe 4 autobusë ku sipas ofertës për ekskursion i plotëson kushtet pasi numri i nxënësve është rreth 115 nxënës.

Ka prezantuar Liçencen e punës e hotelit “Kamomil” me pronar Jorida Zoga , por i mungon Konfirmim rezervimi nga administratori Jorida Zoga , të Hotelit në fjalë .

#### **Vlerësimi i Komisionit selektues:**

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firmat konkurrese, Komisioni selektues ka kërkuar të njoftohen të gjithë prindërit e fëmijëve pjesëmarrës në ekskursion lidhur me ofertat, qëllimin e ekskursionit , lartësinë e pagesës etj, ku me ç’rast takimi është mbajtur me përfaqësuesit e prindërve të nxënësve të klasëve të 12-ta më dt.28.04.2023 nr. protokollit.01/413 .

Nga prindërit është kërkuar Pëlqimi për përzgjedhjen e kompanisë për organizimin e ekskursionit, ku komisionit selektues me dt.28.04.2023 me numër të protokollit 01/413 iu janë prezantuar Deklaratat e Prindërve të Nxënësve të Klasave të 12-ta si dhe Pëlqimi nga KDSH në mbledhjen e mbajtur me dt: 26/04/2023 me numër të protokollit 01/412 .

Komisioni selektues jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për shkollën ”Kadri Kusari” Gjakovë të përzgjidhet firma “**Meti Tours**” SHPK me çmim prej 100€.

Pas shqyrtimit Komisioni vendosi ta zgjedhë agjensinë turistike “**Meti Tours**” SHPK me pronar **Hysen Musa** nga Gjakova .



## Arsyetim

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firmat konkurruese, Pëlqimit nga ana e KDSH me dt:26/04.2023 me numër të protokollit 01/412. Deklaratat e Prindërve lidhur me organizimin e ekskursionit të nënshkruara nga prindërit e nxënësve pjesëmarrës në ekskursion, Procesverbali i mbledhjes me përfaqësues të Prindërve të kl.12-ta me datë 28.04.2023 nr.prot.01/413, Komisioni selektues dhe përfaqësuesit e prindërve jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) në zyrat e DKA-së vendosi të përzgjedhë për SHMLE "Kadri Kusari" në Gjakovë firmën "Meti -Tours" SHPK me çmim prej 100 € .

Kompania e përzgjedhur në fjalë është e obliguar që nxënësit e SHMLE "Kadri Kusar" Gjakovë që t'i respekton të gjitha zotimet në ofertë.

## Komisioni selektues:

1. Merita Bokshi  
(emri dhe mbiemri)

Kryesues i Komisionit dt. 04/05/2023  
(pozita) *elBokshi*

2. Anton Pnishi  
(emri dhe mbiemri)

Anëtar dt. 04/05/2023  
(pozita) *Anton Pnishi*

3. Dukagjin Ademi  
(emri dhe mbiemri)

Anëtar dt. 04/05/2023  
(pozita) *Dukagjin Ademi*

**Këshilla juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 7 ditësh, prej ditës së pranimit të së njëjtit. Ankesa i adresohet Sektorit të Inspektoriatit të Arsimit në Gjakovë.

## Vendimi iu dërgohet:

- Agjencive turistike
- Komisionit të Ankesave
- Shërbimit juridik
- Arkivit

